



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:913563
Datë: 25.07.2023
Numri i dokumentit: 04519464

Rev.nr.221/23

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: O. R. nga P., të cilin e përfaqëson Fatbardh Makolli avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji (KEDS), me seli në P., rruga “...”, nr., të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar M. B., sipas autorizimit, për kompensim dëmi material, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2478/2019, të datës 06.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i të paditurës: Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji (KEDS), me seli në P., rruga ”...”, nr., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2478/2019, të datës 06.04.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2394/2013, të datës 30.11.2018, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit O. R. nga P., ashtu që detyrohet e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji (KEDS), me seli në P., që t’ia paguaj paditësit, në emër të kompensimit të dëmit material, shumën prej 12,326.10 €, në emër të dëmit material, për riparimin e shtëpisë, me kamatë vjetore në lartësi prej 8%, duke filluar, prej datës 30.11.2018, dita kur është marr aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale, në shumën prej 2,150.40 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcenim

të përmbarimit. Në pikën II, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit material dhe atë: në emër të dëmit të shkaktuar, për dëmtimin e tre shtretërve me tre ormanë në shumën prej 3,300 €, në emër të dëmit nga djegia e gardërobës familjare shumën prej 1,700 €, në emër të dëmit nga djegia e tre tepihëve shumën prej 360 €, dhe në emër të djegies të: frigoriferit, klimës, karrocës së fëmijëve, kosës së barit dhe djepit, në shumën prej 800 €, apo në shumën e përgjithshme prej 6,159.90 €.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2478/2019, të datës 06.04.2023, është vendosur: I. Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji (KEDS), me seli në P., ndërsa pika e I, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2394/2013, i datës 30.11.2018, vërtetohet. II. Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2394/2013, i datës 30.11.2018, mbetet e pa shqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni i të paditurës si i bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2394/2013, i datës 30.11.2018, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2478/2019, i datës 06.04.2023, të ndryshohen ashtu që të refuzohet kërkesëpadija e paditësit si e pabazuar, ose të anulohen aktgjykimet e lartcekura dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Paditësi me përgjigje në revizion ka kërkuar që revizioni i të paditurës të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi me datën 19.11.2013, kundër të paditurës, për kompensim dëmit material, duke kërkuar me saktësisht si në kërkesëpadi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.2394/2013, të datës 30.11.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht padinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: kontestuese ka qenë baza e kërkesëpadiisë respektivisht arsyeja e djegies së shtëpisë si dhe lartësia e dëmit të shkaktuar. Bazën e kërkesëpadiisë respektivisht shkaktarin e zjarrit gjykata e shkallës së parë, e ka konstatuar përmes provave siç janë procesverbali i hulumtimit nga zjarri i datës 26.08.2013, me numër evidentues nr...., raporti mbi deklarinimin e rastit i lëshuar nga Policia e Kosovës i datës 21.08.2013, raporti mbi zjarrin e rënë i datës 21.08.2013 i lëshuar nga Komuna e P., e veçanërisht nga ekspertiza teknike, e hartuar me shkrim në muajin prill 2018, nga eksperti Y. Z. - inxhinier i diplomuar i elektroteknikës dhe mendimi i tij plotësues të dhënë në seancën e datës 13.09.2018, në të cilat gjykata në mënyrë të pa dyshimit vërtetoi bazën e kërkesëpadiisë,

për shkaktarin e zjarrit në ditën kritike, më datë 19.09.2013, dhe përgjegjësinë e të paditurës në rastin konkret.

Lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë, e ka konstatuar nga eksperti i caktuar nga gjykata N. M. - inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, nga e cila ekspertizë dhe nga mendimi plotësues i ekspertit në seancën e datës 16.11.2018, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se dëmi i shkaktuar nga zjarri i rënë në shtëpinë e paditësit i datës 19.09.2013, është në shumë prej 12,326.10 €, këtë ekspertizë gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar si profesionale, me të dhënat të mjaftueshme dhe të besueshme, për të caktuar lartësinë e kërkesëpadisë, andaj të njëjtës i ka dhënë besimin.

Gjykata e shkallës së parë i ka refuzuar kërkesat e paditësit si në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, për kompensim të dëmit material lidhur me pajisjet shtëpiake, të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për shkak se paditësi lidhur me këto pretendime, nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë që malli i përshkruar apo orenditë e lartcekura ka qenë në shtëpinë e paditësit dhe është dëmtuar nga zjarri në ditën kritike, andaj gjykata e refuzoj si të pabazuar ngase paditësi pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në asnjë provë që do të ndikonte për të marr ndonjë vendim më të favorshëm ndaj tij lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë. Më tej gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, vlerëson se në rastin konkret në mënyrë të padyshimtë është provuar fakti se më datën dhe kohën e cekur më lartë paditësit i është shkaktuar dëmi në shtëpinë e tij, të përshkruar më lart dhe përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar e bart e paditura, kështu që ekziston baza juridike e kërkesëpadisë dhe se në rastin konkret gjykata është bazuar në nenin 136 të LMD-së.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 136, 137, 140, 154, 155 dhe 169, të LMD - së. Për kamatën iu ka referuar nenit 382 të LMD-së. Për shpenzimet e procedurës iu ka referuar nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.2478/2019, të datës 06.04.2023, ka vendosur që të refuzojë ankesën e të paditurës, dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht, si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykitimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykitimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjen mbështetje në nenin 136, 154, 155, 169, 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit dhe neni 12 paragrafi 1 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Energjinë me nr. 03/L-201.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. 2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. 3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj”.

Me nenin 154 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”.

Me nenin 155 të LMD-së, përcaktohet se: “ Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të ”.

Me nenin 169 paragraf 1, 2, 3 dhe 4 përcaktohet se: “ 1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme ”.

Me nenin 12 paragrafi 1 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Energjinë me nr. 03/L-201, përcaktohet se: “ Operatori i Sistemit të Transmisionit do të jetë përgjegjës për: 1.1. operimin, mirëmbajtjen dhe, zhvillimin e sistemit të transmisionit dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike; 1.2. menaxhimin e rrjedhave të energjisë në sistemin e transmisionit, rrjedhave ndërkuftare, dhe të gjitha kongestionet që mund të paraqiten, duke marrë parasysh këmbimet me sistemet e interkonektuara, në mënyrë që të mbahet balanci mes furnizim dhe kërkesës dhe të sigurohet eficientia ekonomike e menaxhimit të rrjedhave të energjisë ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e dëmit material të shkaktuar më datë 21.08.2013, me rastin e djegies së objektit të paditësit dhe pajisjeve të ndodhura në të.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesëpadia e paditësit në raport me të paditurën është pjesërisht e bazuar sipas dispozitave ligjore të cituara. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë i ka zbatuar dispozitat e lartcekura, e njëjta ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e elektroteknikës dhe ajo e ndërtimtarisë, nga ekspertiza e ekspertit Y. Z., nga lëmia e elektroteknikës është konstatuar se shkaktar i zjarrit është energjia elektrike, si pasojë e furnizimit jo kualitativ me tension të energjisë elektrike. Infrastruktura e RRTU (Rrjeti i tensionit të ultë) në gjendjen e paraqitur nuk garanton se konsumatori do të furnizohet me tension cilësorë dhe kualitet sipas normave dhe rregullave teknike. Matjet e AMRR, nuk tregojnë vlerat e matura në pikën ku konsumatorit i dërgohet energjia elektrike. Në kundërshtim me nenin 9 dhe 10 siç përcaktohet në Rregullën për shkyçjen dhe rikycjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë, si dhe në kundërshtim me masat e sigurisë, normat e përcaktuara dhe rregullat teknike. OSSH (KEDS) nuk ka ndërmarrë masat e shkyçjes së konsumatorit dhe rikycjen e tij, vetëm pas përmirësimit të gjendjes teknike të infrastrukturës së RRTU (Rrjetit i tensionit të ultë). Ndërsa nga ekspertiza nga lëmia e ndërtimtarisë nga eksperti N. M. është konstatuar se: në bazë të dokumentacionit që gjendet në lëndën gjyqësore, dëmi i shkaktuar nga zjarri e ka vlerën 12.326,10 €. Në këtë vlerë janë përfshi punët ndërtimore, ndërtimore - zeytare dhe instalimi elektrik, ndërsa nuk janë përfshi mobilieria dhe pajisjet tjera.

Sa i përket pretendimit të paditurës se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 379 të LPK-së, pasi që nuk është bërë sigurimi i para provës në momentin e shkaktimit të dëmit, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë rast nga provat prezente në shkresat e lëndës, saktësisht Procesverbalit të Hulumtimit nga Zjarri, i përpiluar në ditën e shkaktimit të zjarrit, i lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për Mbrojtje dhe Shpëtim, me të cilin kanë konstatuar se: “ Sipas vendshikimit të vëzhgimit të situatës, zjarri ishte shkaktuar në dritën e dhomës së fjetjes nga tensioni i luhatsëm - shtuar me rastin e fryrjes së erës së madhe gjatë asaj kohe”, rrezulton se kemi provë në shkresat e lëndës që dëshmon se përgjegjës për shkaktimin e dëmit është e paditura, ndërsa nga ekspertiza e ekspertit të elektros dhe ajo e ndërtimtarisë është vërtetuar saktë dhe drejtë përgjegjësia dhe lartësia e dëmit i cili i është shkaktuar paditësit.

Në kuptim të arsyeve të paraqitura në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë dhe vlerësimeve të sipër theksuara, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet sipas revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale për arsye se gjykata e shkallës së dytë dhe as gjykata sipas revizionit nuk kanë mundur

të konstatojnë aplikim të gabuar të së drejtës materiale, prandaj edhe është refuzuar revizioni si i pabazuar.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitura në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të revizionit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.221/23, datë 12.07.2023.

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi